



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“GJEOLOGJI-MINIERA”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

I-II-20

Tiranë, 2020

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	Gjeologji-Miniera			Kodi
Kohëzgjatja	1900-2100 orë	Niveli	II në KSHK, referuar nivelit II të KEK	I-II-20
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në drejtimin <i>“Gjeologji-Miniera”</i> , niveli II ^{të} i KSHK, referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim bazë, në nivelin ndihmës, për t’u punësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me fushën e Gjeologjisë dhe të Minierave dhe në shërbimet e ofruara nga këto fusha, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional <i>“Gjeologji-Miniera”</i> , të nivelit II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional <i>“Gjeologji-Miniera”</i> , niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatë profesionale dhe Supplementin përkatës për punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim. Ky arsimim profesional i jep individit mundësi t’i drejtohet tregut të punës si ndihmës në sipërmarrje të ndryshme gjeologjike, hidro-gjeologjike, minerare, e të tjera që kryejnë veprimtari për kërkim, kërkim-zbulimin dhe shfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishme të ngurta, të naftës e të gazit dhe të ujërave. Me përfundimin e kualifikimit profesional <i>“Gjeologji-Miniera”</i> , niveli II KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III të KSHK, referuar nivelit III të KEK në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtejshëm në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit II të KEK, individi fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	I-I-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë të:

Sfond i përgjithshëm profesional

- Të lexojë dhe interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimet e vizatimit teknik;
- Të përshkruajë klasifikimin e materialeve dhe të lëndëve të para;
- Të listojë përdorimet e materialeve dhe të lëndëve të para;
- Të përshkruajë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të materialeve dhe të lëndëve të para;
- Të përkufizojë objektin e punës dhe veçoritë e proceseve të punës së: Minatorit, Gjeologut, Markshajderit, Armatorit, Shinashtruesit, Sondistit etj.;
- Të përshkruajë parimin e punës së instrumenteve të thjeshta matëse (busulla gjeologjike, busulla e varur etj.);
- Të listojë makinat kryesore që përdoren në fushën e gjeologji-minierave;
- Të tregojë ndryshimin ndërmjet veglave të punës së gjeologut dhe të minatorit;
- Të përshkruajë ndikimet kryesore të punës së tij në mjedisin përreth dhe masat për ruajtjen e mjedisit përreth;

Makinave, veglat dhe pajisjet et punës

- Të klasifikojë makineritë dhe pajisjet e minierës;
- Të listojë veglat dhe pajisjet që përdoren për rrëzimin e mineralit;
- Të listojë veglat dhe makinat e gërmimit në sipërfaqe dhe nëntokë;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet e transportit në minierë;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet e ngarkimit në miniera;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet për largimin e ujërave në miniera;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet për shpimin dhe rrëzimin në minierë;
- Të përshkruajë makineritë dhe pajisjet e ajrimit në minierë;
- Të listojë instrumentet matës në minierë;
- Të përshkruajë pajisjet elektrike që përdoren në minierë dhe masat mbrojtëse prej tyre;

Gjeologji

- Të përshkruajë veçoritë e proceseve të punës të gjeologjisë;
- Të tregojë objektin e studimit të gjeologjisë dhe veçoritë e metodave të studimit që përdoren në gjeologji;
- Të shpjegojë ndërtimin e brendshëm të lëndëve kristalore: llojet, elementët dhe vetitë e kristaleve;
- Të shpjegojë ç 'është minerali, si formohet ai dhe cilat janë format e ndodhjes së tyre në natyrë;
- Të tregojë si shprehet përbërja kimike e mineraleve;
- Të përcaktojë vetitë fizike të mineraleve me sy dhe duke përdorur mjete të thjeshta;

- Të klasifikojë mineralet sipas përbërjes kimike të tyre dhe të tregojë përfaqësuesit kryesorë të çdo klase;
- Të shpjegojë ç'është shkëmbi;
- Të tregojë si ndahen shkëmbinjët në bazë të kushteve të formimit dhe si dallohen ata nga njëri tjetri;
- Të përshkruajë karakteristikat e përgjithshme (format e shtruarjes, struktura, tekstura, ndashmëria) të shkëmbinjve magmatikë, sedimentarë e metamorfikë, që i dallojnë ata nga njëri-tjetri;
- Të përshkruajë në përgjithësi rolin dhe rëndësinë e hartografimit gjeologjik;
- Të përshkruajë materialet bazë, mjetet dhe organizimin e punimeve paraprake;
- Të përshkruajë përdorimin dhe matjen e elementeve të shtresave gjeologjike me busullën gjeologjike: azimutin e shtrirjes, azimutin e rënies, këndin e rënies;
- Të përshkruajë standardet dhe organizimin e punimeve për kryerjen e hartografimeve gjeologjike shumë disiplinore në shkallë të ndryshme;
- Të shpjegojë në përgjithësi metodikën dhe dokumentimin e dukurive gjeologjike në stacionet dhe zhveshjet në terren;
- Të përshkruajë dukuritë gjeologjike në stacionet apo zhveshjet gjeologjike në terren;
- Të përshkruajë procesin e marrjes së provave dhe kampioneve;
- Të shpjegojë metodikën dhe dokumentimin gjeologjik të punimeve minerare dhe shpimeve;
- Të shpjegojë metodat dhe mënyrat e hartografimit gjeologjik;
- Të theksojë kriteret e matjeve, të përshkrimit, të marrjes së provave dhe të kampioneve në mineralet dhe shkëmbinjët, të etiketimit dhe të ambalazhimit;
- Të bëjë përshkrimin e shkurtër të provave dhe të kampioneve, si dhe etiketimin, ambalazhimin dhe dorëzimin e tyre në laboratorët përkatës;
- Të lexojë një hartë gjeologjike, hidrologjike, tektonike, gjeomorfologjike, të rrezikut gjeologjik dhe gjeomjedisor;
- Të përshkruajë fazat dhe strukturën e përpilimit të Raporteve gjeologjike;
- Të karakterizojë elementet e simetrisë së kristaleve dhe të tregojë si grupohen ato në kristalet e ndryshme;
- Të dallojë format e thjeshta kryesore të kristaleve;
- Të bëjë dallimin midis izomorfizmit dhe polimorfizmit;
- Të tregojë metodat laboratorike kryesore të studimit të mineraleve;
- Të shpjegojë si formohen mineralet në natyrë;
- Të shpjegojë ç'është paragjeneza dhe cila është rëndësia e saj praktike;
- Të dallojë format kryesore të ndodhjes së mineraleve në natyrë;
- Të përcaktojë mineralet e studiuara në bazë të formave të ndodhjes dhe vetive fizike;
- Të tregojë metodat që përdoren për studimin shkëmbinjve;
- Të karakterizojë formën, vetitë fizike (dendësinë, rëndësinë, magnetizmin dhe temperaturën), përbërjen kimike dhe ndërtimin e brendshëm të Tokës;
- Të karakterizojë llojet e çarjeve dhe sistemin e çarjeve;
- Të përshkruajë mënyrat e vlerësimit të parametrave kryesorë të çarjeve të ndryshme dhe të bllokshmërisë duke u nisur nga matjet në terren dhe në kampionet e shpimit.
- Të përshkruajë stadet kryesore të evolucionit të Tokës.

- Të tregojë dallimin midis koncepteve “moshë relative” dhe “moshë absolute” e shkëmbinjve.
- Të karakterizojë metodat kryesore (stratigrafike, paleontologjike dhe radiologjike) që përdoren për përcaktimin e moshës së shkëmbinjve.
- Të përshkruajë shkallën gjeokronologjike dhe gjeostratigrafike (deri në periudhë dhe sistem, përkatësisht).
- Të tregojë veçoritë e përgjithshme të proceseve gjeologjike të jashtme (ekzogjene) e të brendshme (endogjene), bashkëveprimin midis tyre dhe si ndahen ato.
- Të përshkruajë veprimtarinë gjeologjike shkatërruese, transportuese dhe akumuluese të shkaktuar nga faktorët e jashtëm (tjetërsimi, veprimtaria e erës, e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore, e lumenjve, e ujërave nëntokësore, e akullnajave, e liqeneve dhe e kënetave, e deteve dhe e oqeanëve, diagjeneza).
- Të përshkruajë veprimtarinë gjeologjike të shkaktuar nga faktorë të brendshëm (lëvizjet malformuese, lëvizjet luhatëse, tërmetet, magmatizmi, metamorfizmi).
- Të karakterizojë strukturat kryesore të kores së Tokës në kontinente dhe në oqeanë.
- Të përshkruajë në vija të përgjithshme teorinë gjeosinklinale dhe atë të tektonikës së pllakave të litosferës për formimin e kores së Tokës.
- Të përshkruajë procesin e dokumentimit gjeologjik dhe minerar;

Miniera

- Të përshkruajë vetitë kryesore fiziko-mekanike të shkëmbinjve;
- Të klasifikojë shkëmbinjtë sipas vetive fiziko-mekanike dhe qëndrueshmërisë;
- Të përshkruajë proceset dhe veçoritë e proceseve të punës në minierë;
- Të listojë dhe përshkruajë punimet minerare dhe gjeologjike;
- Të dallojë punimet minerare horizontale, vertikale dhe të pjerrëta;
- Të përshkruajë proceset e punës për ndërtimin e punimeve minerare.;
- Të përshkruajë pasaportat e shpim-plasjes në punimet minerare të hapjes, përgatitjes dhe shfrytëzimit;
- Të përshkruajë mënyrat, operationet dhe mjetet e nevojshme për ndërtimin e punimeve minerare horizontale e të pjerrëta;
- Të dallojë proceset kryesore nga ato ndihmëse në ndërtimin e punimeve minerare;
- Të përshkruajë skemat e shpërndarjes së birave në një ballë punimi;
- Të përshkruajë kryerjen e proceseve të thjeshta për shpimin e birave;
- Të përshkruajë lëndët dhe mjetet plasëse;
- Të shpjegojë dukurinë dhe mjetet e eksplozionit;
- Të shpjegojë sistemet e nxitjes së plasjes;
- Të shpjegojë rregullat e sigurimit teknik gjatë punëve me lëndë plasëse;
- Të përshkruajë materialet e armatimit;
- Të shpjegojë kryerjen e proceseve të punëve që nevojiten për armatimin e punimeve minerare;
- Të përshkruajë proceset e ngarkim-shkarkimit;
- Të përshkruajë kryerjen e proceseve të punëve të thjeshta në miniera nëntokësore dhe sipërfaqësore;
- Të përshkruajë kriteret e përzgjedhjes së veglave të punës dhe metodat për kryerjen e saj;
- Të përshkruajë mënyrat dhe mjetet e transportit në minierë;

- Të përshkruajë kryerjen e punimeve të thjeshta të armatimit;
- Të përshkruajë procesin e rrëzimit të mineralit me veglat dhe pajisjet përkatëse;
- Të përshkruajë procesin e gërmimit në sipërfaqe dhe nëntokë me mjetet dhe pajisjet përkatëse;
- Të shpjegojë kryerjen e punëve të thjeshta me mjetet e transportit në minierë;
- Të përshkruajë mënyrat dhe mjetet e shpimit të birave;
- Të përshkruajë transhetë dhe elementët e tyre;
- Të përshkruajë procesin e dokumentimit gjeologjik dhe minerar;
- Të përshkruajë punët e transportit në minierë, në sipërfaqe dhe nëntokë;
- Të përshkruajë proceset kryesore dhe mënyrat e ngarkimit të materialit dhe transportit;
- Të listojë proceset për armatimin e punimeve minerare;
- Të përshkruajë proceset kryesore të armatimit;
- Të listojë veglat që përdoren për armatimin e punimeve minerare;
- Të përshkruajë procesin e shtrimit të shinave në sipërfaqe dhe nëntokë;
- Të përshkruajë rëndësinë e largimit të ujërave nga miniera me pajisjet përkatëse;
- Të përshkruajë proceset kryesore të heqjes së ujërave;
- Të përshkruajë procesin e ajrimit të minierës;
- Të përshkruajë rreziqet dhe masat parandaluese të tyre;
- Të listojë pajisjet që përdoren për ajrimin e minierës;
- Të përshkruajë skemat e ajrimit të punimeve minerare;
- Të listojë lëndët plasëse dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë klasifikimin e minierave sipërfaqësore;
- Të përshkruajë punët në minierave sipërfaqësore (karriera);
- Të përshkruajë proceset kryesore të hapjes së puseve;
- Të klasifikojë mënyrat e hapjes së vendburimeve;
- Të klasifikojë sistemet e shfrytëzimit të minerave;

Shpim

- Të përshkruajë përdorimin e makinerive në procesin e shpimit;
- Të përshkruajë procedurën e realizimit të dokumentimit gjeologjik të kampioneve të mineraleve e të shkëmbinjve, si dhe të shllameve, gjatë procesit të shpimit të puseve;
- Të përshkruajë mënyrën e marrjes së provave dhe llojet e analizave laboratorike që kryhen;
- Të përshkruajë kolonën e shpimit, elementët dhe procedurat që ndiqen;
- Të listojë llojet daltave të shpimit (daltat me rrula dhe me diamant);
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së punës për shpimin e puseve të naftës, të ujit si dhe për marrjen e kampioneve;
- Të përshkruajë procedurën e shpimit të puseve;
- Të përshkruajë shkëmbin si objekt i shpimit të pusit;
- Të klasifikojë shkëmbinjte në bazë të vetive fiziko-mekanike;
- Të përshkruajë përdorimin e veglave të punës, instrumentet shkëmb-shkatërrues, tipet dhe llojet e daltave, tubat e shpimit, të rrethimit dhe të shfrytëzimit, që përdoren gjatë proceseve të realizimit të një shpimi;
- Të përshkruajë organizimin e punimeve të shpimit;
- Të përshkruajë mënyrat e shpimit të puseve me motor dhe shpimi i puseve me drejtim të

- caktuar;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse të kolonave të shpimit;
- Të përshkruajë procedurën e realizimit të montimit dhe çmontimit të pjesëve përbërëse të kolonave të shpimit;
- Të përshkruajë funksionimin dhe përdorimet e daltave me elementë të lëvizshëm dhe të palëvizshëm;
- Të përshkruajë funksionimin, ndërtimin dhe përdorimin e daltave me rulo, hidromonitor, me diamante;
- Të përshkruajë se si përzgjidhen daltat për shpimin e shkëmbinjve të caktuar;
- Të përshkruajë procedurat e teknikës së shpimit me ballë të plotë dhe me marrje kampioni;
- Të theksojë problemet e shpimit me marrje kampioni (karote);
- Të përshkruajë përbërësit e lëngjeve larëse të shpimit;
- Të theksojë parametrat e lëngjeve larëse të shpimit;
- Të shpjegojë funksionet e lëngjeve të shpimit;
- Të përshkruajë procesin e larjes së pusit gjatë shpimit dhe agjentët (lëngjet) larës;
- Të shpjegojë sistemin e qarkullimit të lëngut larës në pus;
- Të rendisë treguesit cilësorë dhe sasiorë të shpimit të një pusi;
- Të theksojë faktorët që ndikojnë në treguesit cilësorë dhe sasiorë të shpimit të një pusi;
- Të përshkruajë parametrat e regjimit të shpimit të një pusi;
- Të theksojë shkaqet e shtrembërimit të puseve;
- Të përshkruajë parametrat e shtrembërimit të pusit;
- Të shpjegojë paraqitjen grafike në planin vertikal dhe horizontal të trajektorës së puseve të shtrembër;
- Të listojë llojet e avarive dhe mjetet e eliminimit të tyre;
- Të përshkruajë shpimin e puseve për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe ujërave nëntokësore;
- Të përshkruajë konstruksionin dhe përbërësit e puseve;
- Të listojë shkaqet e bllokimeve të ndryshme të instrumentit të shpimit;
- Të përshkruajë veprimet për zhbllokimin e instrumentit të shpimit;
- Të përshkruajë masat parandaluese dhe ato mënjauese të humbjeve të lëngut larës;
- Të përshkruajë qëllimin e izolimit të shtresave të pusit;
- Të përshkruajë qëllimin e çimentimit të pusit;
- Të rendisë vetitë dhe parametrat e solucionëve të çimentimit nëpërmjet puseve të shpuara;
- Të përshkruajë procesin e realizimit të perdeve kundra-filtrimit me anën e çimentimit të puseve;

Markshajderi

- Të listojë detyrat e Markshajderit;
- Të listojë llojet e skicave dhe dokumentacionit tjetër gjeologo-minerar;
- Të listojë llojet e matjeve që bëhen në minierë dhe gjeologji;
- Të listojë llojet e veglat dhe instrumentet matës që përdoren në minierë dhe gjeologji;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e busullës gjeologjike dhe atë të varur;
- Të përshkruajë mënyrat e matjes dhe llogaritjes së avancimit të punimeve minerare, gjeologjike dhe të shpimit;
- Të përshkruajë mënyrën dhe procedurën e ndërtimit të planimetrive të thjeshta;

- Të përshkruajë elementët e një Projekt Rehabilitimi të thjeshtë të mjedisit;
- Të lexojë vizatime të thjeshta ndërtimi: plan të përgjithshëm, planimetri, pamje, prerje, etj.;
- Të lexojë vizatime të thjeshta të shtresave dhe trupave të mineralizuar dhe të punimeve minerare, duke përdorur simbolet dhe konvencionet përkatëse;
- Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së skicave dhe vizatimeve të karrierave dhe galerive;
- Të përshkruajë pajisjet ndihmëse që përdoren për matje në gjeologji-miniera dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre;
- Të përshkruajë hartat topografike dhe të lexojë drejt ato.
- Të përshkruajë mënyrën e matjes së distancat në harta;
- Të dallojë instrumentet matëse;
- Të përshkruajë matjen e distancave me pajisje matëse elektronike;
- Të shpjegojë kuptimin e kuotave dhe nivelacionit;
- Të listojë instrumentet që përdoren në nivelacion; ë përshkruajë mënyrat e vendosjes në terren të pikave dhe reperëve të fortë.

Siguria dhe shëndeti në punë

- Të përshkruajë parime të përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në miniera, gjeologji dhe punimet e shpimit;
- Të përshkruajë parimet e klasifikimit të aksidenteve të ndodhura dhe regjistrimin e tyre në ditarin e sigurisë në punë dhe të shëndetit
- Të theksojë kushtet e punës në minierat sipërfaqësore, burimet e aksidenteve nga punët me lëndë plasëse;
- Të listojë/ rreziqet që vijnë nga prania e gazeve në miniera dhe masat mbrojtëse;
- Të përshkruajë burimet e aksidenteve nga rënia e gurëve nga shkallët e karrierës, burimet e aksidenteve gjatë hapjes së transeve të thella në formacione të paqëndrueshme;
- Të përshkruajë rreziqet që vijnë nga thyerjet e gurëve me përmasa të mëdha dhe gjatë përpunimit të tyre në thyerësat, rrëshqitjet e shpateve të shkallëve dhe transeve.
- Të përshkruajë rreziqet nga pajisjet elektrike në kushte punë normale dhe në ditë me shira dhe lagështi;
- Të përshkruajë dëmtimet e shëndetit nga zhurmat e makinerive dhe shpërthimeve masive, masat mbrojtëse dhe pajisjet personale, dëmtimet e shëndetit nga pluhurat e ngritura nga shpërthimet masive dhe impiantet e thyerjes dhe përpunimit të lëndës së parë, dëmtime të shëndetit nga kushtet e vështira atmosferike në periudhat e ftohta dhe me reshje dëbore;
- Të përshkruajë kushtet e punës për një punë normale gjatë dimrit;
- Të listojë mjetet mbrojtëse individuale në miniera, pikat e grumbullimit në raste të avarive dhe aksidenteve në miniera për marrjen e ndihmës së parë;
- Të dallojë sinjalistikën e lëvizjeve në miniera, pikat e informacionit për gjendjen e ajrimit në miniera, etj.;
- Të përshkruajë burimet e aksidenteve nga makineritë e ndryshme në karriera;
- Të përcaktojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, si dhe rolin e ndriçimit dhe krijimi i kushteve të sigurta në punë;
- Të vlerësojë përdorimet e mjeteve të mbrojtjes individuale në punë gjatë montim-çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje ngritjeve të

instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, përdorimit të metodave të dyta;

- Të theksojë përdorimet e mjeteve të mbrojtjes gjatë manovrimit të kompresorëve, motorëve me djegie të brendshme dhe pompave, si dhe gjatë grumbullimit, transportit dhe ruajtjes së naftës e gazit;
- Të përshkruajë rëndësinë e planit të emergjencës në minierë (PEM);
- Të përshkruajë krehjen e frontit të punës, armatimin, masat për ajrimin, lëvizjen e pajisjeve;
- Të listojë rreziqet që vijnë nga shpërthimet e gazrave në minierat me regjim gazi, masat për shmangien e tyre dhe si veprohet në rastet kur ato ndodhin;
- Të listojë rreziqet që paraqiten në frontet e shfrytëzimit, kujdesin nga shembjet, lëvizjet e makinerive, rrëshqitjet e mineralit dhe pajisjeve të punës në frontet e pjerrëta;
- Të listojë rreziqet që vijnë nga shpërthimet e ujërave në miniera dhe masat për shmangien e aksidenteve ;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes, transportit dhe përdorimit të lëndëve plasëse në miniera;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes, kujdesit dhe mirëmbajtjes të rrjetit elektrik në minierat;
- Të listojë shkaqet e aksidenteve gjatë shpimit të puseve dhe nxjerrjes së naftës e gazit, si dhe masat për parandalimin e tyre. Të listojë rregullat e ruajtjes së shëndetit në raste pandemie;

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Sfondi i përgjithshëm profesional

- Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
- Të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës;
- Të kryejë kontrollin vizual të vazhdueshëm të veglave që përdor;
- Të përdorë mjetet dhe materialet e punës;
- Të mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës;
- Të përdorë veglat e thjeshta të Gjeologut;
- Të përdorë veglat e thjeshta të Shpuesit;
- Të përdorë veglat e thjeshta të Minatorit;
- Të përdorë veglat e thjeshta të Markshajderit;
- Të zgjidhë probleme të thjeshta që lidhen me ruajtjen e mjedisit.
- Të respektojë standardet dhe etikën e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së shëndetit, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit;

Gjeologji

- Të realizojë hartografime të thjeshta të vendit të punës; në sipërfaqe të minierës;
- Të kryejë veprime praktike në ndërtimin e transheve dhe të elementeve të tyre;
- Të realizojë dokumentime të thjeshta gjeologjike, minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve të dobishme;

- Të përgatisë materialet e nevojshme për të kryer dokumentimin gjeologjik;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të punimeve minerare sipërfaqësore dhe nëntokësore të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit të vendburimeve të mineraleve të dobishme;
- Të kryejë dokumentimin gjeologjik të kampioneve të mineraleve e të shkëmbinjve, si dhe të shllameve, gjatë procesit të shpimit të puseve;
- Të kryejë marrjen e provave për analiza laboratorike, etiketimin, ambalazhimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, sipas metodikave dhe instruksioneve të miratuara;
- Të bëjë matjen e elementeve të shtruarjes së shtresës me anë të busullës. gjeologjike;
- Të skicojë dukuritë gjeologjike në stacionet apo zhveshjet gjeologjike në terren;
- Të dokumentojë dukuritë gjeologjike në stacionet apo zhveshjet gjeologjike në terren;
- Të prezantojë karakteristikat e përgjithshme (format e shtruarjes, struktura, tekstura, ndashmëria) të shkëmbinjve magmatikë, sedimentarë e metamorfikë, që i dallojnë ata nga njëri-tjetri.
- Të përcaktojë vetitë fizike të mineraleve me sy dhe duke përdorur mjete të thjeshta.

Miniera

- Të kryejë veprime praktike në punimet e shpimit dhe të rrëzimit në miniera, në sipërfaqe;
- Të kryejë veprime praktike në punimet e gërmimit dhe të ngarkimit të shkëmbinjve në miniera, në sipërfaqe;
- Të kryejë veprime praktike në punët e transportit në miniera, në sipërfaqe;
- Të kryejë veprime praktike në punimet e stivimit të shkëmbinjve;
- Të kryejë veprime praktike në ndërtimin e rrugëve në minierat sipërfaqësore;
- Të kryejë veprime praktike për përgatitjen e elementeve të armatimit të punimeve minerare horizontale në poligon,;
- Të kryejë veprime praktike në shtrimin e shinave në minierë; sipërfaqësore
- Të kryejnë punime ngarkimi dhe transporti në sipërfaqe;
- Të mirëmbajë çekiçin shpues dhe rrëzues;
- Të përdorë në poligon vegla dhe makina të thjeshta gërmimi dhe të ngarkimit që përdoren në sipërfaqe dhe në nëntokë;
- Të kryejë veprime praktike në punët e transportit në miniera, në sipërfaqe me vagonët;
- Të realizojë në poligon armaturën që përdoret në punimet horizontale;
- Të kryej veprimtari praktike që lidhen me proceset e largimit të ujërave nga punimet horizontale dhe të pjerrëta;
- Të montojë në poligon pajisje të thjeshta të ajrimit të minierës që përdoren në nëntokë;
- Të manovrojë me makineri të thjeshta nën mbikëqyrjen e specialistëve në sipërfaqe;

Shpim

- Të kryejë punime të thjeshta me vegla dhe agregate të thjeshta;
- Të monitorojë qarkullimin e lëngjeve larës dhe të raportojë për problemet që dalin;
- Të kryejë sistemimin e kampioneve dhe të shllameve, gjatë procesit të shpimit të puseve;
- Të kryejë marrjen e provave për analiza laboratorike, etiketimin, ambalazhimin dhe dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, sipas metodikave dhe instruksioneve të miratuara;
- Të kryejë veprime praktike për ngritjen e kolonave të shpimit;
- Të vendosë daltat për shpimin e shkëmbinjve të caktuar në pajisjet përkatëse;
- Të kryejë veprime të thjeshta praktike gjatë shpimit të puseve;

- Të zgjedhë daltat për shpimin e shkëmbinjve të caktuar;
- Të kryejë veprime praktike gjatë shpimit të puseve;
- Të zbatojë procesin e karotimit të shkëmbinjve;

Markshajderi

- Të përgatisë skica dhe vizatime teknike të thjeshta të galerive;
- Të përdorë busullën gjeologjike dhe busullën e varur;
- Të masë dhe llogarisë avancimin e punimeve minerare horizontale;
- Të kryejë punime përgatitore (hapjen e gropave, vendosjen e betonit, etj.) për vendosjen e pikave të forta të bazamentit gjeodezik të minierës;
- Të kryejë punime të thjeshta matëse në minierat nëntokësore dhe sipërfaqësore;
- Të përgatitë, për punë, instrumentet matëse (shiritmetër, busull, latë, instrumente matëse, etj.) që përdoren në gjeologji e miniera;
- Të kryejë punime simuluese (në poligon, ose laborator) për vendosjen e pikave markshajderike në gjeologji e minierë, në sipërfaqe dhe nëntokë;
- Të kryejë punime të thjeshta që kanë të bëjnë me ndjekjen e punimeve në terren (ruajtja e drejtimit të ecjes së punimeve, ruajtja e pjerrësisë së shinave, etj.);
- Të kryejë punime rehabilituese dhe të ruajtjes së mjedisit;
- Të masë distanca me shiritmetër;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të vëllimeve të stoqeve;
- Të materializojë në terren pika dhe reperë të fortë ;

Teknika e sigurimit

- Të zbatojë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë në miniera, gjeologji dhe punimet e shpimit;
- Të zbatojë rregullat Sigurimit teknik të punës në minierat sipërfaqësore;
- Të zbatojë rregullat e Sigurimit teknik dhe masat mbrojtëse në stimulimet nga prania e gazeve në miniera;
- Të zbatojë rregullat Sigurimit teknik në stimulimet e aksidenteve nga rënia e gurëve nga shkallët e karrierës dhe gjatë hapjes së transeve të thella në formacione të paqëndrueshme;
- Të zbatojë rregullat sigurimit teknik gjatë përdorimit të makinerive në karriera;
- Të vendosë rrethimin dhe sinjalistikën në minierat sipërfaqësore;
- Të zbatojë rregullat Sigurimit teknik gjatë procesit të thyerjes së gurëve me përmasa të mëdha dhe gjatë përpunimit të tyre në thyersat, rrëshqitjet e shpateve të shkallëve dhe transeve;
- Të përdorë pajisjet mbrojtëse ndaj zhurmave dhe pluhurave;
- Të demonstrojë përdorimin e mjeteve mbrojtëse dhe dhënien e ndihmës së parë;
- Të përgatisë tabela të sinjalistikës së lëvizjes në miniera, pikave të informacionit, ajrimit në miniera, etj.;
- Të respektojë rregullat e Sigurimit teknik për t'u mbrojtur nga makineritë e ndryshme në karriera;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë gjatë përdorimit të energjisë elektrike, në karriera në kushte punë normale dhe në ditë me shira dhe lagështi;
- Të respektojë standardet e ndriçimit për krijimin e kushteve të sigurta në punë;

- Të përdorë mjetet e mbrojtjes individuale në punë gjatë montim – çmontimit të sondave dhe pajisjeve të shpimit, gjatë procesit të shpimit, ulje-ngritjeve të instrumenteve, tubimit, çimentimit, likuidimit të avarive, përgatitjes dhe përdorimit të lëngut larës, përdorimit të metodave të dyta;
- Të përdorë mjetet mbrojtëse gjatë manovrimit të kompresorëve, motorëve me djegie të brendshme dhe pompave, si dhe gjatë grumbullimit, transportit dhe ruajtjes së naftës e gazit.
- Të kryejë punime të thjeshta të krehjes së frontit të punës në poligon
- Të bëjë kanalet për të shmangur rreziqet që vijnë nga shpërthimet e ujërave në miniera;
- Të zbatojë rregullat e ruajtjes së shëndetit në raste pandemie;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficientë;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënimit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vet vlerësoje nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.